



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHITETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .06.2025

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga A.Ç., gazetares kujto.al
E-mail:

BERAT

E nderuar znj. Ç.!

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), me email datë 29.05.2025, me anë të së cilës kërkonti *informacion për disa çështje që në lidhjen me dëmshpërblimin financiar të ish-të përndjekurve politikë*, lutem gjeni më poshtë informacionin e hartuar nga strukturat përkatëse të institucionit sipas çështjeve të ngritura:

1-Cilës datë i përket ky postim <https://autoritetidosjeve.gov.al/blog/autoriteti-proponon-disa-ndryshime-ne-ligjin-per-demshperblimin-e-ish-te-denuarve-politike-te-regjimit-komunist>? -

Postimi është bërë në 22 shtator 2023.

Autoriteti propozon disa ndryshime në ligjin për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist

☞ *Ndryshimet prekin të internuarit në kampe me tela me gjemba; të lindurit dhe të miturit nën 15 vjeç, në internim; rritjen e masës së dëmshpërblimit, me 25 vite burgim, për familjarët e të ekzekutuarve; vendosjen e pagesës fikse për të dënuarit me punë të detyruar si dhe zgjatje të afatit për subjektet përfituese.*

👉 AIDSSH në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, vlerëson pozitivisht nismën për disa ndryshime në ligjin “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, si dhe shpreh dakordësinë për përfshirjen e Autoritetit në institucionet e parashikuara për zbatimin e këtij ligji.

👉 Nisur nga problematikat dhe përvojat e punës, artikulumet nga Shoqata së ish-të Përndjekurve Politikë dhe grupet e interesit, si dhe pas analizës së legjislacionit mbi dëmshpërblimet në tërësi, AIDSSH konsideron të nevojshëm shtimin dhe ndryshimin e dispozitave të tjera, përtej atyre që janë parashikuar deri më tani në këtë projekt-ligj, konkretisht në:

→ **Adresimin e përshtatshëm ligjor të situatës së personave që vuajtën në kampe të internimit me tela me gjemba me qëllim vërtetimin e periudhës së internimit si dhe masën e dëmshpërblimit.** Dëmshpërblimi i kësaj kategorie të internuarish deri më

tani ka qenë i pamundur për shkak të vështirësisë për të provuar internimin si dhe periudhën e vuajtjes në kampe.

Ky adresim përfshin verifikimin e nevojshëm administrativ edhe përmes dokumenteve alternativë të para 1991 të tilla si komunikata ditore të policisë, tabela, radiograme, dosje të hetuesisë, dosje formulare, dëshmi të të mbijetuarve, të dhënat e administruara dhe vendimet (dokument pas vitit 1991) e komisioneve të mëparshme, si për shembull, ai i njohur si Komisioni Tri-Palësh.

Këto dokumente mund të merren në konsideratë për qëllime të vërtetimit të periudhës së internimit si dhe masën e dëmshpërblimit.

Për rastet e pamundësisë së evidentimit të numrit të saktë të ditëve të kaluara në internim në kampe me tela me gjemba, ***propozojmë parashikimin e një mase dëmshpërblimi fikse të përcaktuar në ligj në vend se me 1000 lekë për ditë sic është parashikimi aktual.***

Ndryshimi duhet të përcaktojë edhe rolin e AIDSSH në këtë proces, sidomos bashkëpunimin e ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë edhe përmes ngritjes së grupeve të punës apo task force të përbashkëta për verifikime posaçërisht të internimeve në kampe me tela me gjemba me vështirësi dokumentimi jo për faj të personave të internuar dhe verifikime të rasteve të të lindurve apo të miturve në internim.

→ **Adresimin e përshtatshëm ligjor të situatës së personave që lindën në internim apo ishin të mitur, nën moshën 15 vjeç**, në kushte të internimit, me qëllim mundësinë e verifikimit administrativ, vërtetimit të internimit, përcaktimit të rolit të AIDSSH në këtë proces, si dhe përfitimit të një dëmshpërblimi qoftë edhe simbolik. Përfshirja e këtij propozimi në ndryshimet e ligjit çon në rrëzimin e kufizimit moshor për përfitim nga të miturit që vuajtën në kampet e internimit me tela me gjemba.

AIDSSH ka konstatuar vështirësinë e dokumentimit dhe pengesa për dëmshpërblime të personave që kanë lindur në internim ose kanë qenë të mitur në kohën e internimit pasi aktet administrative apo dokumente zyrtarë të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi kanë qenë për prindërit ndërsa për të lindurit a të miturit në internim, nuk ka akte individuale të kësaj natyre. Ndërkaq Udhëzimi nr. 2, datë 4.1.1992 në pikën 10 të tij parashikon se koha e internimit dhe e dëbimit për motive politike, nuk njihet si vjetërsi pune përpara moshës 15 vjeç.

Për raste pamundësie të llogaritjes së kohës së saktë të kaluar në internim, sugjerohet edhe për këtë kategori alokimi i një shume fikse dëmshpërbluese.

→ **Prioritizimin, për efekt pagese, të rrethit të familjarëve për viktimat e vrara apo të ekzekutuara gjatë komunizmit**, harmonizimin e përkufizimit, në nenin 8, të “rrethit të familjarëve” dhe rrethit të trashëgimtarëve me Kodin Civil, për qëllime të përfitimit sipas nenit 7 të ligjit, si dhe ***barazimin e masës së dëmshpërblimit sipas nenit 7 jo me 8 vite burgim por me 25 vite burgim.***

→ **Zgjatja e afatit, deri më 31 dhjetor të vitit 2025, për të gjithë subjektet përfituese.** Një afat më i gjatë do ishte i nevojshëm edhe për të krijuar mundësi dhe hapësira të verifikimit të përshtatshëm për kategoritë e lartpërmendura, nëse situata e tyre adresohet sipas këtyre sugjerimeve.

→ **Përshpejtimin e procesit për dëmshpërblimet e mbetura.** Për përfitues të cilët për shkak moshe a gjendjeje shëndetësore (si kur përfituesi është vetë ish-i përndjekuri përfitues, ashtu edhe për familjarë të viktimave të vrara apo të ekzekutuara), përfitimi i plotë i masës së dëmshpërblimit duket të ketë probabilitet të ulët, konsiderimin e mundësisë së pagesës së shumës së mbetur në një kësht total të vetëm e jo me kësht të copëzuara, në një kohë sa më të afërt.

→ Të gjithë ish-të përndjekurit të cilët, në kushtet e vuajtjes së dënimit, kanë kryer edhe punë të detyruar (si për shembull në miniera) të konsiderohet mundësia e një **pagese fikse mujore si shpërblim për punën e detyruar**, e cila nuk prek përfitimet e tjera të deritanishme.

■ Autoriteti në punën e tij, mes të tjerash, është edhe platformë shërbimesh për qytetarët me të dhëna arkivore për kërkesat për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi, si dhe për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit.

↪ Që prej vitit 2017 e deri me sot, Autoriteti ka trajtuar 1220 kërkesa të kësaj natyre, ku një në tre ka rezultuar pa të dhëna arkivore. Me miratimin e ndryshimeve të propozuara nga AIDSSH kësaj kategorie ish- të përndjekurish politikë u jepet mundësia të bëhen pjesë e procesit të dëmshpërblimit dhe rehabilitimit.

☞ AIDSSH vijon punën në drejtim të zbatimit të detyrave të ngarkuara me ligj nga Kuvendi, si dhe inkurajon dhe fton në bashkëpunim institucionet përgjegjëse për të gjetur zgjidhje efikase në zbatim të ligjeve për dëmshpërblimin dhe rehabilitimin e ish- të përndjekurve politike, pasi vihet re që disa prej tyre ende nuk po gjejnë zbatim, dhe kjo jo për faj të viktimave.

2- Po hartohet një projektligj i ri për dëmshpërblimin e të përndjekurve? Në c'fazë është ai dhe sa mundësi ka që këto propozime të reflektohen?

Përgjigje - Veprimet zyrtare të ndërmarra nga Autoriteti janë si vijon:

1. Shkresë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me propozimet si me poshte:

- i. Adresim i situatës të ish-të internuarve në kampe me tela me gjemba, pasi ka mungesë të akteve administrative apo dokumenteve zyrtare që provojnë internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba, jo për faj të personave të internuar.
- ii. Parashikim i shprehur ligjor për njohjen dhe dëmshpërblimin e personave që kanë lindur në internim apo kanë qenë nën moshën 15 vjeç në kushte internimi.
- iii. Sugjerimin mbi zgjatjen e afatit deri në 31 dhjetor 2025, pasi ka nevojë për më shumë kohë për efekte verifikimi dhe dokumentimi.
- iv. Prioritizimi i rrethit të familjarëve për viktimat e vrara apo të ekzekutuara gjatë periudhës 30.11.1944-01.10.1991, ripërkufizimi dhe rishikimi i masës së dëmshpërblimit duke mos e barazuar me atë të 8 viteve burgim të padrejtë, por minimalisht me atë të dënimit maksimal me burgim 25 vite.
- v. Dëmshpërblimet e mbetura. Të shihet mundësia e pagesës së shumës së mbetur në një derdhje të vetme e jo me kësht, në një kohë sa më të afërt.
- vi. Shpërblim për punë të detyruar gjatë vuajtjes së dënimit. Për të gjithë ish-të përndjekurit të cilët në kushtet e vuajtjes së dënimit kanë kryer edhe punë të detyruar

(si për shembull në miniera) të konsiderohet mundësia e një pagese fikse mujore si shpërblim për punën e detyruar, e cila nuk prek përfitimet e tjera të deritanishme.

2. Me shkesën nr. 3648 prot., datë 01.07.2024, protokolluar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me nr. 1115 prot., datë 03.07.2024, Ministria e Drejtësisë dërgon për mendim projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar. Në këtë projektligj të Ministrisë së Drejtësisë është vlerësuar dhe reflektuar propozimi ynë mbi zgjatjen e afatit për paraqitjen e kërkesës deri në 31.12.2025 dhe nuk janë marrë në konsideratë propozimet e tjera. Në këto kushte pas diskutimit në Autoritet u vendos që të përcillen Ministrisë së Drejtësisë përsëri edhe propozimet e tjera, të cilat nuk ishin marrë në konsideratë, dërguar këto të fundit në nëntor 2024.

Referuar faqes zyrtare të Kuvendit (Kalendari i punimeve të Kuvendit për periudhën 29 Maj-18 Qershor 2025, miratuar në seancë plenare të datës 29.05.2025):

Çështja: Projektligji "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

Komisioni për dhënie mendimi: Komisioni për çështjet ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Shqyrtimi në seancë plenare: _____ (s'ka datë).

3-Nisur nga kjo që ju thoni "Autoriteti në punën e tij, mes të tjerash, është edhe platformë shërbimesh me të dhëna arkivore për kërkesat për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi si dhe për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit", si edhe "Që prej vitit 2017 e deri me sot, Autoriteti ka trajtuar 1220 kërkesa të kësaj natyre ku një në tre ka rezultuar pa të dhëna arkivore", mund të saktësoni sa kërkesa ka pasur për cdo lloj dënimi dhe për çfarë arsyeje kërkohen këto vërtetime? Kuptoj kërkesat e ish-të burgosurve gjatë vitit 2017, kur pati një zgjatje të afatit për dorëzimin e dokumenteve për dëmshpërblim, por më pas, të interesuarit, vazhdojnë ende të aplikojnë?

Përgjigje: Kërkohen vërtetime për internime/debime/ burgime (per arsye politike) për arsye të dokumentimit ligjor dhe provimit të statusit të të përndjekurit politik, në funksion të përfitimit të dëmshpërblimit financiar dhe/ose përfitimeve të tjera ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9831/2007 dhe ligje të tjera që lidhen me të përndjekurit politikë. Arsyet kryesore janë:

Për të vërtetuar ekzistencën e ngjarjes

– Ligji kërkon që personi të provojë me dokument arkivor zyrtar, të krijuar përpara vitit 1991, se ka qenë i burgosur, internuar ose dëbuar për motive politike.

Për të përcaktuar periudhën e dënimit/internimit

– Kjo është thelbësore sepse dëmshpërblimi llogaritet në bazë të ditëve, muajve ose viteve të kaluara në burg apo internim.

Për të mbrojtur integritetin e skemës së dëmshpërblimit

– Kërkimi i dokumenteve zyrtare siguron që vetëm personat që realisht kanë vuajtur përndjekje politike të përfitojnë nga ligji, duke parandaluar abuzimet.

Për të përmbushur kërkesat ligjore procedurale

– Ministria e Drejtësisë dhe komisionet që shqyrtojnë aplikimet për dëmshpërblim kanë

nevojë për prova të qarta dhe të verifikueshme për të marrë vendim për pranimin apo refuzimin e kërkesës.

Për të ndihmuar në ndarjen e kategorive të përfituesve

– Në disa raste, si për kampet me rrethim me tela me gjemba apo për të lindurit në internim, kërkohet dokumentacion i veçantë, pasi trajtimi ligjor është më i ndërlikuar dhe i ndryshëm nga trajtimi standard.

Pra, vërtetimet shërbejnë si bazë ligjore dhe administrative për njohjen e statusit dhe për përfitimin e të drejtave të parashikuara për të përndjekurit politikë.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka trajtuar 1,220 kërkesa për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi që nga viti 2017. Sipas statistikave të nxjerra nga ana e tyre, rreth një në tre kërkesa kanë rezultuar pa të dhëna arkivore. Kërkesat përfshijnë:

Vërtetime për periudhat e internimit apo burgimit, të cilat përdoren për:

- Proceset e rehabilitimit ligjor.
- Përfitimin e dëmshpërblimeve financiare sipas ligjit për të përndjekurit politikë.
- Dokumentimin e historisë familjare dhe personale.

Vazhdueshmëria e aplikimeve pas vitit 2017

Edhe pas përfundimit të afatit për dorëzimin e dokumenteve për dëmshpërblim në vitin 2017, individë të ndryshëm vazhdojnë të paraqesin kërkesa pranë AIDSSH-së. Disa arsye janë:

- Zbulimi i vonuar: Shumë individë ose familjarë të tyre mund të kenë gjetur ose janë informuar për ekzistencën e dokumenteve relevante vetëm pas këtij afati.
- Përpjekje për rehabilitim moral dhe historik: Pavarësisht nga përfitimet financiare, shumë individë kërkojnë të dokumentojnë dhe njohin vuajtjet e tyre ose të familjarëve të tyre gjatë regjimit komunist.
- Nevoja për dokumentacion në procese të tjera ligjore: Disa kërkesa lidhen me procese gjyqësore të vazhdueshme ose të reja që kërkojnë dokumentacion të mëtejshëm.

Mungesa e të dhënave arkivore

Rreth 33% e kërkesave kanë rezultuar pa të dhëna arkivore që mund të jetë pasojë e:

- Shkatërrimit të dokumenteve: Gjatë periudhave të ndryshme, veçanërisht gjatë tranzicionit pas rënies së regjimit komunist, shumë dokumente janë shkatërruar ose humbur.
- Mungesës së regjistrimeve të sakta: Në disa raste, veprimet represive nuk janë dokumentuar në mënyrë të plotë ose të saktë nga autoritetet e kohës.
- Problemeve me identifikimin e saktë të individëve: Ndryshimet në emra, mbiemra ose të dhëna personale mund të kenë ndikuar në pamundësinë për të gjetur dokumentacionin përkatës.

4-Ligji në fuqi për dëmshpërblimin, lë jashtë, personat e vrarë para 30 nëntorit 1944. As ju nuk keni propozuar që ata të përfshihen. Cila është arsyeja?

Përgjigje- Arsyeja pse personat e vrarë para datës 30 nëntor 1944 nuk janë përfshirë në ligjin në fuqi për dëmshpërblimin (ligji nr. 9831/2007) dhe as në propozimet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), lidhet me kufirin kohor që ligjvënësi ka vendosur për të konsideruar një akt si i kryer nga regjimi komunist. Konkretisht:

- Ligji ekzistues e lidh periudhën e dënimeve politike me fillimin zyrtar të pushtetit komunist, që në mënyrë konvencionale dhe ligjore është vendosur të jetë 29 nëntori 1944.
- Vrasjet ose represionet para kësaj date konsiderohen si të ndodhura në kontekst të luftës ose periudhës së tranzicionit, dhe jo nën regjimin komunist të konsoliduar.
- Për rrjedhojë, ligji për dëmshpërblimin i referohet veçanërisht atyre që u dënuan, u internuan apo u vranë nga strukturat shtetërore të regjimit komunist pas vendosjes së tij.

Pse nuk është propozuar nga AIDSSH përfshirja e viktimave para 30.11.1944?

- Objekti i ligjit nr. 45/2015, i referohet dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe strukturave të regjimit komunist, të krijuara pas marrjes së pushtetit.
- Viktimat para kësaj date nuk bien brenda periudhës së dokumentuar nga këto struktura, dhe si rrjedhojë nuk janë pjesë e juridiksionit të drejtpërdrejtë të AIDSSH për verifikim ose rekomandim dëmshpërblimi.

Nëse do të kishte një nismë për zgjerimin e periudhës së dëmshpërblimeve, kjo do të kërkonte:

- Një vendimmarrje politike për të rishikuar kufirin kohor.
- Analizë historike dhe ligjore për të përcaktuar kriteret e përgjegjësisë shtetërore para krijimit formal të regjimit komunist.

5-Sa persona rezultojnë të vrarë për motive politike nga forcat komuniste, gjatë luftës, para 30 nëntorit 1944?

Nuk kemi informacion.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti